

“SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË” SH.A
RAPORT I BASHKIMIT ME PËRTHITHJE

H16/1
H. 10.09.2020

RAPORT

I BASHKIMIT ME PËRTHITHJE TE SHOQËRISË “TIPOGRAFIA
USHTARAKE” SHA NGA SHOQËRIA SHTYPSHKRONJA E LETRAVE
ME VLERË SHA

SHOQËRIA “SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË” SHA



**RAPORTI I BASHKIMI ME PËRTHITHJE E SHOQËRISË “TIPOGRAFIA
USHTARAKE” SH.A NGA SHOQËRIA “SHTYP SHKRONJA E LETRAVE ME
VLERË” SH.A**

Raporti I bashkimit me përthithje është hartuar në përputhje me nenin 216 të ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” i ndryshuar, pika 2: Raporti I bashkimit nga:

Z. Besmir HYSA Administrator I shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a

Bashkimi me përthithje është inicuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si aksioneri i vetëm i shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a, Tiranë dhe i shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a, Tiranë.

Në përputhje me ligjin Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” i ndryshuar, neni 216, pika 2, me vendim të aksionerit të vetëm të shoqërive hartohet ky raport për bashkimin me përthithje të shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a, nga shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a.

Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a, shoqëri aksionere me kapital të regjistruar prej 430,238,000 lekë, i ndarë në 430,238 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksion, tërësisht i paguar, me seli tek Rruga “Qemal Stafa” tek ish “Tipografia Ushtarake” Tiranë, datë themelimi më 01/09/2008, e përfaqësuar nga administrator i Shoqërisë Z. Besmir HYSA.

Projektmarveshja e bashkimit është hartuar në respektim të plotë të ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” i ndryshuar, ligjit 9723 datë 03/05/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”


Bashkimi me përthithje është menduar për arritjen e objektivave të kësaj shoqërie, për shërbime sa më të mira të klientëve si dhe rritjen e marzheve të fitimit.

Përkufizime dhe Inerpretime

Në këtë Raport Bashkimi, përveçse kur kuptohet ndryshe ose kur cilësohet ndryshe më tej, fjalët e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

- “Raport Bashkimi” nënkupton këtë Raport Bashkimi

2 | P a g e



“SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË” SH.A
RAPORT I BASHKIMIT ME PËRTHITHJE

- **“Shoqëri Përthithëse”** në këtë Raport Bashkimi do të thotë Shoqëria “Shtypshkronja e letrave me vlerë”sh.a
- **“Shoqëri e Përthithur”** në këtë Raport Bashkimi do të thotë Shoqëria “Tipografia Ushtarake”sh.a
- **“Data e realizimit përfundimtar të bashkimit” (data efektive e bashkimit)** ka kuptimin që i është dhënë në paragrafin e mëposhtëm që do të thotë, data e miratimit të Projekt marrëveshjes nga aksioneri i vetëm dhe i depozitimit të këtyre dokumentave në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- **“Data e bashkimit”** ka kuptimin që i është dhënë në paragrafin e datës kontabël që do të thotë data 31/12/2019
- **“Informacioni Kofidencial”** nënkupton çdo informacion, me shkrim ose me gojë në lidhje me aktivitetin financiar ose aktivitete të tjera të shoqërive.
- **“Qendra Kombëtare e Biznesit”** nënkupton njësinë e themeluar në bazë të ligjit nr.923, datë 03/04/2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Shoqëritë që marrin pjesë në bashkim me përthithje

Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a, shoqëri aksionere me kapital të regjistruar prej 430,238,000 lekë, i ndarë në 430,238 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksion, tërësisht i paguar, me seli tek Rruga “Qemal Stafa, “Tipografia Ushtarake” Tiranë, datë themelimi më 01/09/2008, e përfaqësuar nga administrator i Shoqërisë Z. Besmir HYSA, e cila për qëllim të kësaj marrëveshje do të quhet “Shoqëria Përthithëse”.

Shoqëria “Tipografia Ushtarake”sh.a, shoqëri aksionere me kapital të regjistruar prej 66,857,000 lekë, i ndarë në 66,857 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion, tërësisht i paguar, me seli Rruga “Qemal Stafa”. Tiranë, datë themelimi më 11/07/1997, e përfaqësuar nga administrator i Shoqërisë Znj. Fabiola HOXHA që për qëllim të kësaj marrëveshje do të quhet “Shoqëria e Përthithur”.

Shoqëria “Tipografia Ushtarake” sh.a do ti transferojë shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a, tërësinë e elementëve të aktivitetit të pasivitetit duke përfshirë dhe ato që rezultojnë nga operacionet e kryera gjatë periudhës ushtrimore deri në datën e bashkimit.

Bashkimi, Raporti i këmbimit të aksioneve

Në bazë të kushteve të Projektmarëveshjes së lidhur shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a do të përthithë shoqërinë “Tipografia Ushtarake” sh.a në Datën e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit që është data e miratimit të projektmarëveshjes nga aksioneri I vetëm I të dyja shoqërive dhe I depozitimit të këtyre dokumentave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Shoqëria “Tipografia Ushtarake” sh.a do ti transferojë shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a tërësinë e kapitaleve neto duke përfshirë dhe ato që rezultojnë nga operacionet e kryera gjatë periudhës ushtrimore deri në Datën Efektive të Bashkimit.

Të dyja shoqëritë që marrin pjesë në procesin e bashkimit me përthithje zotërohen nga i njëjti aksioner, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Kapitali i “Shoqërisë Përthithëse” është në shumën 430,238,000 lekë, i ndarë në 430,238 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksion.

Kapitali i shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a, nga përthithja e Shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a, Zvogelohet me vlerën 9,575,000 lekë, dhe shuma për 959 lekë do të kalojë në Zvogelimin e zërit rezerva për efekt të rumbullakimit të vlerës së aksioneve. Pas Zvogelimit nga procesi I bashkimit Kapitali i “Shoqërisë Përthithëse” nga 430,238,000 lekë bëhet 420,663,000 lekë, i ndarë në 420,663 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksion

Data e bashkimit është data 31/12/2019, që do të thotë se të gjitha operacionet e kryera nga “Tipografia Ushtarake” sh.a që nga data 01/01/2020 dhe deri në datën e Regjistrimit përfundimtar në QKB do të konsiderohen sit ë kryera nga “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a.

Anëtarët e organeve drejtuese të shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a në datën e realizimit përfundimtar të bashkimit do të vazhdojnë të jenë anëtarët e organeve drejtuese të Shoqërisë Përthithëse.

Statuti i shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a, mbas ndryshimeve që mund të bëhen do të jetë Statuti i Shoqërisë Përthithëse.

Administrator i Shoqërisë Përthithëse do të jetë Z. Besmir HYSA, i cili do të ushtrojë kompetencat e administrimit të shoqërisë së bashkuar sipas ligjit dhe statutit të shoqërisë.

Selia e Shoqërisë Përthithëse do të jetë Selia e Shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”: ish “Tipografia Ushtarake” Tiranë

Data e hartimit të pasqyrave financiare që I është referuar data e Bashkimit

Llogaritë që janë përdorur për të përcaktuar vlerën e ndryshimit të kapitalit të shoqërisë, janë referuar Pasqyrave financiare në datë 31/12/2019.

Data e përcaktuar për trajtimin kontabël të veprimeve të kryera.

Në aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarisë të kryera prej Shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a nga data 01 janar 2020 deri në datën e regjistrimit përfundimtar të procesit të bashkimit pranë QKB-së, datë në të cilën do të ndodhë çregjistrimi pa likuidim i Shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a, do të konsiderohen si të kryera nga shoqëria Përthithëse “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a, dhe regjistrimet kontabël përkatëse do të merren në librat e saj.

Duke qënë se data mbi të cilin do të bëhet bashkimi është data 31/12/2019, bilanci përfundimtar i përthithjes do të jetë bilanci i të dyja shoqërive i datës 31/12/2019.

Kushtet e ndarjes së aksioneve si dhe data për ndarjen e fitimit të Shoqërisë përthithëse

Aksionet në “Shoqërinë Përthithëse” zotërohen vetëm nga një aksioner, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duke e konsideruar këtë fakt, nuk ka kushte të ndarjes së aksioneve, si dhe përcaktimin e një date për ndarjen e fitimit.

Të drejta dhe avantazhe të veçanta

Ky operacion bashkimi me përthithje nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë.

Pasojat që do të ketë bashkimi ndaj punëmarrësve

Punëmarrësit e Shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a mbas datës së bashkimit me përthithje do të përfshihen si punëmarrës tek Shoqëria Përthithëse

Modalitetet

Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a do të jetë zotëruese e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a në datën e bashkimit.

Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a në datën e realizimit përfundimtar të bashkimit do të zotërojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, licensat e zotëruara nga shoqëria “Tipografia Ushtarake” sh.a në këtë datë.

Punëmarrësit e shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a do të përfshihen mbas datës së bashkimit si punëmarrës tek Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a.

Garancitë për kreditorët dhe mbrojtja e tyre

E rëndësishme në këtë procedurë bashkimi me përthithje të shoqërive të mësipërme, është garantimi i kreditorëve të shoqërive që marrin pjesë në këtë bashkim, sidomos ata të shoqërisë së përthithur (të cilat do të jenë pjesë në raportin e ekspertit kontabël), për faktin se:

Debitori fillestar humbet formën ligjore ose çregjistrohet (Shoqëria e përthithur), detyrimet e saj sipas ligjit i transferohen Shoqërisë përthithëse “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a.

Në zbatim të ligjit Shoqëria përthithëse merr përsipër të bëhet pasardhëse e shoqërisë së përthithur në marrëdhënie me të tretët, duke garantuar në këtë mënyrë kreditorët e shoqërisë së përthithur, që ti drejtojnë të gjitha pretendimet e tyre ndaj Shoqërisë përthithëse “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a.

Premtime deri në mbyllje dhe pas mbylljes

Deri në datën e mbylljes, palët bien dakord për:

- Të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të miratuar dhe autorizuar këtë Raport Bashkimi si dhe dokumenta të tjera në lidhje me to.
- Të njoftojnë Drejtoritë Rajonale Tatimore ku janë të regjistruara si subjekt në lidhje me operacionin e bashkimit.
- Të ndërmarrin çdo veprim për depozitimin e të gjithë dokumentacionit pranë QKB-së brenda afateve ligjore.
- Kalimin e të punësuarëve nga shoqëria e përthithur tek shoqëria përthithëse pas procesit të mbylljes.
- Mbyllja e operacionit të bashkimit do të bëhet në selinë e shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a në adresën Rruga “Qemal Stafa” tek ish Tipografia Ushtarake Tiranë.

Deklarimet dhe garancitë

Deklarimet dhe garancitë e shoqërisë përthithëse “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a

Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a dhe përfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë Marrveshje Bashkimi dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.

Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a nuk është në proces falimentimi, në shkrirje apo në proces likuidimi.

“SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË” SH.A
RAPORT I BASHKIMIT ME PËRTHITHJE

Konfidencialiteti

Palët do të trajtojnë në mënyrë konfidenciale të gjitha informacionet e marra dhe të përfituara si rezultat i realizimit të kësaj Raport Bashkimi, që ka të bëjë me negociatat si dhe me çdo dokument tjetër që referohet nga kjo Raport Bashkimi.

Palët mund të japin informacion një pale të tretë, i cili mund të konsiderohet konfidencial nëse:

- Kërkohej me ligj ose me qëllim të ndonjë procedure ligjore
- Kërkohej nga ndonjë institucion qeveritar
- Me miratimin paraprak dhe me shkrim të palës tjetër.

Të ndryshme

Raporti I bashkimit me përthithje të shoqërive u hartua nga Administratori I shoqërisë, sipas ligjit dhe do të depozitohet së bashku me projektmarveshjen e bashkimit me përthithje pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Raporti I Bashkimit u hartua sot në date 10/09/2020, në 6 kopje origjinale dhe u nënshkrua nga:

Shoqëria “ Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”

Përfaqësuar nga:

Besmir Hysa

Z. Besmir Hysa administrator i shoqërisë



52
Dt 10.09.2020

RAPORT

I BASHKIMIT ME PËRTHITHJE TË SHOQËRISË "TIPOGRAFIA
USHTARAKE" SHA NGA SHOQËRIA "SHTYPSHKRONJA E LETRAVE
ME VLERË" SHA

SHOQËRIA "TIPOGRAFIA USHTARAKE" SHA



**RAPORTI I BASHKIMI ME PËRTHITHJE E SHOQËRISË “TIPOGRAFIA
USHTARAKE” SH.A NGA SHOQËRIA “SHTYP SHKRONJA E LETRAVE ME
VLERË” SH.A**

Raporti I bashkimit me përthithje është hartuar në përputhje me nenin 216 të ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” i ndryshuar, pika 2: Raporti I bashkimit nga:

Z. Fabiola HOXHA Administrator I shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a

Bashkimi me përthithje është inicuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si aksioneri i vetëm i shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a, Tiranë dhe i shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a, Tiranë.

Në përputhje me ligjin Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” i ndryshuar, neni 216, pika 2, me vendim të aksionerit të vetëm të shoqërive hartohet ky raport për bashkimin me përthithje të shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a, nga shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a.

Shoqëria “Tipografia Ushtarake” sh.a, shoqëri aksionere me kapital të regjistruar prej 66,857,000 lekë, i ndarë në 66,857 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion, tërësisht i paguar, me seli Rruga “Qemal Stafa”. Tiranë, datë themelimi më 11/07/1997, e përfaqësuar nga administrator i Shoqërisë Znj. Fabiola HOXHA që për qëllim të këtij raporti do të quhet “Shoqëria e Përthithur”.

Projektmarveshja e bashkimit është hartuar në respektim të plotë të ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” i ndryshuar, ligjit 9723 datë 03/05/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

Bashkimi me përthithje është menduar për përmirësimin e performancës ekonomike, të kësaj shoqërie, pasi është në vështirësi financiare.

Përkufizime dhe Inerpretime

Në këtë Raport Bashkimi, përveçse kur kuptohet ndryshe ose kur cilësohet ndryshe më tej, fjalët e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

- “**Raport Bashkimi**” nënkupton këtë Raport Bashkimi
- “**Shoqëri Përthithëse**” në këtë Raport Bashkimi do të thotë Shoqëria “Shtypshkronja e letrave me vlerë” sh.a

- **“Shoqëri e Përthithur”** në këtë Raport Bashkimi do të thotë Shoqëria “Tipografia Ushtarake” sh.a
- **“Data e realizimit përfundimtar të bashkimit” (data efektive e bashkimit)** ka kuptimin që i është dhënë në paragrafin e mëposhtëm që do të thotë, data e miratimit të Projektmarëveshjes nga aksioneri i vetëm dhe i depozitimit të këtyre dokumentave në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- **“Data e bashkimit”** ka kuptimin që i është dhënë në paragrafin e datës kontabël që do të thotë data 31/12/2019
- **“Informacioni Kofidencial”** nënkupton çdo informacion, me shkrim ose me gojë në lidhje me aktivitetin financiar ose aktivitete të tjera të shoqërive.
- **“Qendra Kombëtare e Biznesit”** nënkupton njësinë e themeluar në bazë të ligjit nr.923, datë 03/04/2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Bashkimi, Raporti i këmbimit të aksioneve

Në bazë të kushteve të Projektmarëveshjes së lidhur shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a do të përthithë shoqërinë “Tipografia Ushtarake” sh.a në Datën e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit që është data e miratimit të projektmarëveshjes nga aksioneri I vetëm I të dyja shoqërive dhe I depozitimit të këtyre dokumentave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Shoqëria “Tipografia Ushtarake” sh.a do të transferojë shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a tërësinë e kapitaleve neto duke përfshirë dhe ato që rezultojnë nga operacionet e kryera gjatë periudhës ushtrimore deri në Datën Efektive të Bashkimit.

Të dyja shoqëritë që marrin pjesë në procesin e bashkimit me përthithje zotërohen nga i njëjti aksioner, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Kapitali i “Shoqërisë Përthithëse” është në shumën 430,238,000 lekë, i ndarë në 430,238 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksion.

Kapitali i shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a, nga përthithja e Shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a Zvogelohet me vlerën 9,575,000 lekë, dhe shuma për 959 lekë do të kalojë në Zvogelimin e zërit rezerva për efekt të rumbullakimit të vlerës së aksioneve. Pas Zvogelimit nga procesi I bashkimit Kapitali i “Shoqërisë Përthithëse” nga 430,238,000 lekë bëhet 420,663,000 lekë, i ndarë në 420,663 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksion

Data e bashkimit është data 31/12/2019, që do të thotë se të gjitha operacionet e kryera nga “Tipografia Ushtarake” sh.a që nga data 01/01/2020 dhe deri në datën e Regjistrimit përfundimtar në QKB do të konsiderohen si të kryera nga “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a.

Anëtarët e organeve drejtuese të shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”sh.a në datën e realizimit përfundimtar të bashkimit do të vazhdojnë të jenë anëtarët e organeve drejtuese të Shoqërisë Përthithëse.

Statuti i shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”sh.a, mbas ndryshimeve që mund të bëhen do të jetë Statuti i Shoqërisë Përthithëse.

Administrator i Shoqërisë Përthithëse do të jetë Z. Besmir HYSA, i cili do të ushtrojë kompetencat e administrimit të shoqërisë së bashkuar sipas ligjit dhe statutit të shoqërisë.

Selia e Shoqërisë Përthithëse do të jetë Selia e Shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”: ish “Tipografia Ushtarake” Tiranë


Data e hartimit të pasqyrave financiare që I është referuar data e Bashkimit

Llogaritë që janë përdorur për të përcaktuar vlerën e ndryshimit të kapitalit të shoqërisë, janë referuar Pasqyrave financiare në datë 31/12/2019.

Data e përcaktuar për trajtimin kontabël të veprimeve të krvera.

Në aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarisë të kryera prej Shoqërisë “Tipografia Ushtarake”sh.a nga data 01 janar 2020 deri në datën e regjistrimit përfundimtar të procesit të bashkimit pranë QKB-së, datë në të cilën do të ndodhë çregjistrimi pa likuidim i Shoqërisë “Tipografia Ushtarake”sh.a, do të konsiderohen si të kryera nga shoqëria Përthithëse “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”sh.a, dhe regjistrimet kontabël përkatëse do të merren në librat e saj.

Duke qënë se data mbi të cilin do të bëhet bashkimi është data 31/12/2019, bilanci përfundimtar i përthithjes do të jetë bilanci i të dyja shoqërive i datës 31/12/2019.



Kushtet e ndarjes së aksioneve si dhe data për ndarjen e fitimit të Shoqërisë përthithëse

Aksionet në “Shoqërinë Përthithëse” zotërohen vetëm nga një aksioner, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duke e konsideruar këtë fakt, nuk ka kushte të ndarjes së aksioneve, si dhe përcaktimin e një date për ndarjen e fitimit.

Të drejta dhe avantazhe të veçanta

Ky operacion bashkimi me përthithje nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë.

Pasojat që do të ketë bashkimi ndaj punëmarrësve

Punëmarrësit e Shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a mbas datës së bashkimit me përthithje do të përfshihen si punëmarrës tek Shoqëria Përthithëse

Modalitetet

Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a do të jetë zotëruese e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a në datën e bashkimit.

Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a në datën e realizimit përfundimtar të bashkimit do të zotërojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, licensat e zotëruara nga shoqëria “Tipografia Ushtarake” sh.a në këtë datë.

Punëmarrësit e shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a do të përfshihen mbas datës së bashkimit si punëmarrës tek Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a.

Garancitë për kreditorët dhe mbrojtja e tyre

E rëndësishme në këtë procedurë bashkimi me përthithje të shoqërive të mësipërme, është garantimi i kreditorëve të shoqërive që marrin pjesë në këtë bashkim, sidomos ata të shoqërisë së përthithur (të cilat do të jenë pjesë në raportin e ekspertit kontabël), për faktin se:

Debitori fillestar humbet formën ligjore ose çregjistrohet (Shoqëria e përthithur), detyrimet e saj sipas ligjit i transferohen Shoqërisë përthithëse “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a.

Në zbatim të ligjit Shoqëria përthithëse merr përsipër të bëhet pasardhëse e shoqërisë së përthithur në marrëdhënie me të tretët, duke garantuar në këtë mënyrë kreditorët e shoqërisë së

përthithur, që ti drejtojnë të gjitha pretendimet e tyre ndaj Shoqërisë përthithëse "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a.

Premtime deri në mbyllje dhe pas mbylljes

Deri në datën e mbylljes, palët bien dakord për:

- Të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të miratuar dhe autorizuar këtë Raport Bashkimi si dhe dokumenta të tjera në lidhje me to.
- Të njoftojnë Drejtorinë Rajonale Tatimore ku janë të regjistruara si subjekt në lidhje me operacionin e bashkimit.
- Të ndërmarrin çdo veprim për depozitimin e të gjithë dokumentacionit pranë QKB-së brenda afateve ligjore.
- Kalimin e të punësuarëve nga shoqëria e përthithur tek shoqëria përthithëse pas procesit të mbylljes.
- Mbyllja e operacionit të bashkimit do të bëhet në selinë e shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a në adresën Rruga "Qemal Stafa" tek ish Tipografia Ushtarake Tiranë.

Deklarimet dhe garancitë

Deklarimet dhe garancitë e shoqërisë përthithëse "Tipografia Ushtarake" sh.a

Shoqëria "Tipografia Ushtarake" sh.a dhe përfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë marrveshje Bashkimi dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.

Shoqëria "Tipografia Ushtarake" sh.a nuk është në proces falimentimi, në shkrirje apo në proces likuidimi.

Konfidencialiteti

Palët do të trajtojnë në mënyrë konfidenciale të gjitha informacionet e marra dhe të përfituara si rezultat i realizimit të kësaj Raport Bashkimi, që ka të bëjë me negociatat si dhe me çdo dokument tjetër që referohet nga kjo Raport Bashkimi.

Palët mund të japin informacion një pale të tretë, i cili mund të konsiderohet konfidencial nëse:

- Kërkohe me ligj ose me qëllim të ndonjë procedure ligjore
- Kërkohe nga ndonjë institucion qeveritar
- Me miratimin paraprak dhe me shkrim të palës tjetër.



“TIPOGRAFIA USHTARAKE” SH.A
RAPORT I BASHKIMIT ME PËRTHITHJE


Të ndryshme

Raporti I bashkimit me përthithje të shoqërive u hartua nga Administratori I shoqërisë, sipas ligjit dhe do të depozitohet së bashku me projektmarveshjen e bashkimit me përthithje pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Raporti I Bashkimit u hartua sot në date 10/09/2020, në 6 kopje origjinale dhe u nënshkrua nga:

Shoqëria “ Tipografia Ushtarake” sha

Përfaqësuar nga:

Fabiola HOXHA 
Znj. Fabiola HOXHA administrator i shoqërisë



416
dt. 10.09.2020

PROJEKTI I MARRËVESHJES SË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE

Ndërmjet

SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË SHA

Si Shoqëri përthithëse

Dhe

TIPOGRAFIA USHTARAKE SHA

Si shoqëri e përthithur



PROJEKTMARRËVESHJE BASHKIMI ME PËRTHITHJE E SHOQËRISË
“TIPOGRAFIA USHTARAKE” SH.A NGA SHOQËRIA “SHTYPSHKRONJA E
LETRAVE ME VLERË” SH.A

Ky projekt bashkimi me përthithje është hartuar nga:

Administratori i shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a, Z. Besmir HYSA

Dhe

Administratori i shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a, Znj Fabiola HOXHA

Ky projekt është iniciuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si aksioneri i vetëm i shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a, Tiranë dhe i shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a, Tiranë.

Në përputhje me ligjin Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” i ndryshuar, pjesa IX, neni 215 deri tek neni 225 me vendim të aksionerit të vetëm të shoqërive hartohet kjo Projekt marrëveshje për bashkimin me përthithje të shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a, nga shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a.

Me vendimin Nr.1 datë 04/01/2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është urdhëruar:

1. Bashkimi me përthithje i shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a, nga shoqëria “Shtypshkronja e letrave me vlerë” sh.a.
2. Të hartohet marrëveshja dhe raporti i bashkimit sipas nenit 216 të ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 “ Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” i ndryshuar
3. Shoqëria e re përthithëse do të quhet “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a Tiranë.
4. Administratori i shoqërisë përthithëse do të jetë Z. Besmir HYSA, administrator aktual i shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a sh.a Tiranë.
5. Eksperti kontabël Znj. Anita Pulaj të hartojë raportin e bashkimit, sipas nenit 217 të ligjit 9901, datë 14/04/2008 “ Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” i ndryshuar
6. Shoqëria “ Tipografia Ushtarake” sh.a, Tiranë pas përfundimit të bashkimit, vlerësohet e prishur, sipas nenit 220 të ligjit 9901, datë 14/04/2008 “ Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” i ndryshuar, ndaj rregjistrohet nga QKB, sipas seksionit V të ligjit Nr.9723, datë 03/05/2007 “ Për Regjistrin e Biznesit.
7. Të zmadhohet kapitali i shoqërisë përthithëse sipas vlerës së përcaktuar nga Eksperti kontabël.

2 / Page


Në zbatim të këtij vendimi të aksionerit të dyja shoqëritë kanë rënë dakord për të hartuar këtë projekt marrëveshje, në mënyrë që të përcaktojnë afatet dhe kushtet e të drejtave dhe të detyrimeve respektive në përputhje me procesin e bashkimit.

Të dyja shoqëritë kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Përkufizime dhe Interpretime

Në këtë Projekt marrëveshje, përveçse kur kuptohet ndryshe ose kur cilësohet ndryshe më tej, fjalët e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

- **“Projekt marrëveshje”** nënkupton këtë projekt marrëveshje
- **“Shoqëri Përthithëse”** në këtë projekt marrëveshje do të thotë Shoqëria “Shtypshkronja e letrave me vlerë” sh.a
- **“Shoqëri e Përthithur”** në këtë projekt marrëveshje do të thotë Shoqëria “Tipografia Ushtarake” sh.a
- **“Data e realizimit përfundimtar të bashkimit” (data efektive e bashkimit)** ka kuptimin që i është dhënë në paragrafin e mëposhtëm që do të thotë, data e miratimit të projekt marrëveshjes nga aksioneri i vetëm dhe i depozitimit të këtyre dokumentave në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- **“Data e bashkimit”** ka kuptimin që i është dhënë në paragrafin e datës kontabël që do të thotë data 31/12/2019
- **“Informacioni Kofidencial”** nënkupton çdo informacion, me shkrim ose me gojë në lidhje me aktivitetin financiar ose aktivitete të tjera të shoqërive.
- **“Qendra Kombëtare e Biznesit”** nënkupton njësinë e themeluar në bazë të ligjit nr.923, datë 03/04/2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.
- **“Data e nënshkrimit”** nënkupton datën e nënshkrimit të kësaj projekt marrëveshje nga të dyja palët, ashtu siç tregohet në faqet e nënshkruara të kësaj projekt marrëveshjeje.



Page

Shoqëritë që marrin pjesë në bashkim me përthithje

Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a, shoqëri aksionere me kapital të regjistruar prej 430,238,000 lekë, i ndarë në 430,238 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion, tërësisht i paguar, me seli tek ish “Tipografia Ushtarake” Tiranë, datë themelimi më 01/09/2008, e përfaqësuar nga administrator i Shoqërisë Z. Besmir HYSA, e cila për qëllim të kësaj marrëveshje do të quhet “Shoqëria Përthithëse”.

Shoqëria “Tipografia Ushtarake” sh.a, shoqëri aksionere me kapital të regjistruar prej 66,857,000 lekë, i ndarë në 66,857 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion, tërësisht i paguar, me seli Rruga “Qemal Stafa”. Tiranë, datë themelimi më 11/07/1997, e përfaqësuar nga administrator i Shoqërisë Znj. Fabiola HOXHA që për qëllim të kësaj marrëveshje do të quhet “Shoqëria e Përthithur”.

Në bazë të kushteve të kësaj projekt marrëveshje Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a do të përthithë Shoqërinë “Tipografia Ushtarake” sh.a në datën e realizimit përfundimtar të bashkimit, që është data e miratimit të projekt marrëveshjes nga aksioneri i vetëm i shoqërive dhe depozitimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria “Tipografia Ushtarake” sh.a do ti transferojë shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a, tërësinë e elementëve të aktivitetit të pasivitetit duke përfshirë dhe ato që rezultojnë nga operacionet e kryera gjatë periudhës ushtrimore deri në datën e bashkimit.

Raporti i këmbimit të aksioneve

Të dyja shoqëritë që marrin pjesë në procesin e bashkimit me përthithje zotërohen nga i njëjti aksioner, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Kapitali i “Shoqërisë Përthithëse” është në shumën 430,238,000 lekë, i ndarë në 430,238 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion. Nga ndryshimet mëparshme të kapitalit të kësaj shoqërie numri i aksioneve nuk ka ndryshuar, duke zmadhuar kapitalin me rritjen vlerës për secilin aksioner.

Kapitali i shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a, nga përthithja e Shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a Zvogelohet me vlerën 9,575,000 lekë, dhe shuma për 959 lekë do të kalojë në Zvogelimin e zërit rezerva për efekt të rumbullakimit të vlerës së aksioneve. Pas Zvogelimit nga procesi I bashkimit Kapitali i “Shoqërisë Përthithëse” nga 430,238,000 lekë bëhet 420,663,000 lekë, i ndarë në 420,663 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksion

4 | Page

Kushtet e ndarjes së aksioneve si dhe data për ndarjen e fitimit të Shoqërisë përthithëse

Aksionet në “Shoqërinë Përthithëse” zotërohen vetëm nga një aksioner, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duke e konsideruar këtë fakt, nuk ka kushte të ndarjes së aksioneve, si dhe përcaktimin e një date për ndarjen e fitimit.

Data e përcaktuar për trajtimin kontabël të veprimeve të kryera.

Në aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarisë të kryera prej Shoqërisë “Tipografia Ushtarake”sh.a nga data 01 janar 2020 deri në datën e regjistrimit përfundimtar të procesit të bashkimit pranë QKB-së, datë në të cilën do të ndodhë çregjistrimi pa likuidim i Shoqërisë “Tipografia Ushtarake”sh.a, do të konsiderohen si të kryera nga shoqëria Përthithëse “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”sh.a, dhe regjistrimet kontabël përkatëse do të merren në librat e saj.

Duke qënë se data mbi të cilin do të bëhet bashkimi është data 31/12/2020, bilanci përfundimtar i përthithjes do të jetë bilanci i të dyja shoqërive i datës 31/12/2020.

Të drejta dhe avantazhe të veçanta

Ky operacion bashkimi me përthithje nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë.

Përparësitë e organeve të administrimit

Anëtarët e organeve drejtuese të shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”sh.a në datën e realizimit përfundimtar të bashkimit do të vazhdojnë të jenë anëtarët e organeve drejtuese të Shoqërisë Përthithëse.

Statuti i shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”sh.a, mbas ndryshimeve që mund të bëhen do të jetë Statuti i Shoqërisë Përthithëse.

Administrator i Shoqërisë Përthithëse do të jetë Z. Besmir HYSA, i cili do të ushtrojë kompetencat e administrimit të shoqërisë së bashkuar sipas ligjit dhe statutit të shoqërisë.

Selia e Shoqërisë Përthithëse do të jetë Selia e Shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”: ish “Tipografia Ushtarake” Tiranë

Pasojat që do të ketë bashkimi ndaj punëmarrësve

Punëmarrësit e Shoqërisë “Tipografia Ushtarake”sh.a mbas datës së bashkimit me përthithje do të përfshihen si punëmarrës tek Shoqëria Përthithëse

5 | P a g e

Modalitetet

Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a do të jetë zotëuese e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a në datën e bashkimit.

Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a në datën e realizimit përfundimtar të bashkimit do të zotërojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, licensat e zotëruara nga shoqëria “Tipografia Ushtarake” sh.a në këtë datë.

Punëmarrësit e shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a do të përfshihen mbas datës së bashkimit si punëmarrës tek Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a.

Garancitë për kreditorët dhe mbrojtja e tyre

E rëndësishme në këtë procedurë bashkimi me përthithje të shoqërive të mësipërme, është garantimi i kreditorëve të shoqërive që marrin pjesë në këtë bashkim, sidomos ata të shoqërisë së përthithur (të cilat do të jenë pjesë në raportin e ekspertit kontabël), për faktin se:

Debitori fillestar humbet formën ligjore ose çregjistrohet (Shoqëria e përthithur), detyrimet e saj sipas ligjit i transferohen Shoqërisë përthithëse “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a.

Në zbatim të ligjit Shoqëria përthithëse merr përsipër të bëhet pasardhëse e shoqërisë së përthithur në marrëdhënie me të tretët, duke garantuar në këtë mënyrë kreditorët e shoqërisë së përthithur, që ti drejtojnë të gjitha pretendimet e tyre ndaj Shoqërisë përthithëse “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a.

Ekspertët

Me qëllim, vlerësimin e kushteve të kësaj projekt marrëveshje të bashkimit, për të dyja shoqëritë pjesëmarrëse, në këtë procedurë bashkimi me përthithje, me vendimin Nr.1 datë 04/01/2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë është emëruar Znj. Anita Pulaj, me nr. ID 030808698, banuese në Tiranë, eksperte kontabël e regjistruar (Audituese ligjore) anëtare e IEKA, mbajtëse e licencës me nr. 155 datë 19/05/2006.

Eksperti ngarkohet sipas ligjit të hartojë një raport me shkrim, nëpërmjet të cilit do të deklarojë dhe vlerësojë kapitalin e shoqërive.

Kapitali i shoqërisë përthithëse, (shoqërisë përfituese të kontributeve) pas realizimit të procesit të bashkimit me përthithjen e shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a (shoqëria kontribuese) do të përbëhet nga kapitali I regjistruar I shoqërisë përthithëse në shumën 430,238,000 lekë dhe kapitalet e veta në vlerë negative të “Shoqërisë së Përthithur në shumën (9,575,959) lekë,

Kapitali i shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a, nga përthithja e Shoqërisë “Tipografia Ushtarake” sh.a Zvogelohet me vlerën 9,575,000 lekë, dhe shuma për 959 lekë do të kalojë në Zvogelimin e zërit rezerva për efekt të rumbullakimit të vlerës së aksioneve. Pas

Zvogelimit nga procesi I bashkimit Kapitali i “Shoqërisë Përthithëse” nga 430,238,000 lekë bëhet 420,663,000 lekë, i ndarë në 420,663 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksion

Shoqëritë pjesmarrëse në këtë proces bashkimi me përthithje, garantojnë sipas ligjit, se ekspertit do ti vihet në dispozicion i gjithë informacioni dhe dokumentat përkatëse, me qëllimin e kryerjes së procedurave ligjore.

Premtime deri në mbyllje dhe pas mbylljes

Deri në datën e mbylljes, palët bien dakord për:

- Të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të miratuar dhe autorizuar këtë projekt marrëveshje si dhe dokumenta të tjera në lidhje me to.
- Të njoftojnë Drejtorinë Rajonale Tatimore ku janë të regjistruara si subjekt në lidhje me operacionin e bashkimit.
- Të ndërmarrin çdo veprim për depozitimin e të gjithë dokumentacionit pranë QKB-së brenda afateve ligjore.
- Kalimin e të punësuarëve nga shoqëria e përthithur tek shoqëria përthithëse pas procesit të mbylljes.

Deklarimet dhe garancitë

Deklarimet dhe garancitë e shoqërisë përthithëse “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a

Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a dhe përfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë projekt marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.

Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a nuk është në proces falimentimi, në shkrirje apo në proces likuidimi.

Deklarimet dhe garancitë e shoqërisë së përthithur “Tipografia Ushtarake” sh.a

Shoqëria “Tipografia Ushtarake” sh.a dhe përfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë projekt marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.

Shoqëria “Tipografia Ushtarake” sh.a nuk është në proces falimentimi, në shkrirje apo në proces likuidimi.

7 | Page

Konfidencialiteti

Palët do të trajtojnë në mënyrë konfidenciale të gjitha informacionet e marra dhe të përfituara si rezultat i realizimit të kësaj projekt marrëveshje, që ka të bëjë me negociatat si dhe me çdo dokument tjetër që referohet nga kjo projekt marrëveshje.

Palët mund të japin informacion një pale të tretë, i cili mund të konsiderohet konfidencial nëse:

- Kërkohe me ligj ose me qëllim të ndonjë procedure ligjore
- Kërkohe nga ndonjë institucion qeveritar
- Me miratimin paraprak dhe me shkrim të palës tjetër.

Të përgjithshme

Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesmarrëse në këtë procedurë bashkimi me përthithje, do të hartojnë sipas ligjit (neni 216) një raport të hollësishëm, në të cilën do të shpjegohen marrëveshja e bashkimit, baza ligjore dhe ekonomike për të, vështirësitë e veçanta të cilat mund të jenë hasur. Raporti do të përshkruajë dhe pasojat e këtij bashkimi mbi punëmarrësit e këtyre shoqërive.

Projekt marrëveshja dhe raporti i bashkimit do të depozitohen sipas ligjit në QKB, jo më vonë se 1 muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, për marrjen e vendimit të përcaktuar në nenin 218 të ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, në mënyrë të detyrueshme do të publikohen pasqyrat financiare vjetore, raportet përkatëse të ecurisë së veprimtarive të të dyja shoqërive, për të paktën tri vitet e fundit.

Autorizohet Znj. *Fabiola Hoxha* të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për depozitimin e të gjitha akteve për realizimin e procedurës së bashkimit me përthithje.

Zgjidhja e projekt marrëveshjes

Kjo projekt marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë para datës së mbylljes me aprovimin me shkrim të të dyja palëve.

Kjo projekt marrëveshje mund të përfundojë nga secila palë me anë të njoftimit me shkrim te pala tjetër, para datës së mbylljes, nëse bashkimi nuk përfundon.

Të ndryshme

Të gjitha komunikimet, njoftimet dhe shpalljet e kërkuara nga kjo projekt marrëveshje do të dorëzohen dorazi ose me anë të postës në adresat si më poshtë vijon: (palët do të njoftohen për ndryshimet e adresave)

8 | P a g e

Shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a

Shoqëria “Tipografia Ushtarake” sh.a

Adresa Sh. Tipografia ushtarake

Adresa Bi. Demel Stepe, Tirane

Në vëmendje të Z. Besmir HYSA

Në vëmendje të Znj. Fabiola HOXHA

Asnjë ndryshim i kësaj projekt marrëveshje nuk do të jetë i vlefshëm përveçse me shkrim dhe e nënshkruar nga të dyja palët.

Kjo projekt marrëveshje u hartua sot në date 10/09/2020, në 6 kopje origjinale dhe u nënshkrua nga:

Shoqëria

Shoqëria

Shtypshkronja e Letrave me Vlerë

Tipografia Ushtarake

Përfaqësuar nga:

Përfaqësuar nga:

Besmir Hysa

Fabiola Hoxha

Z. Besmir HYSA administrator i shoqërisë

Znj. Fabiola HOXHA administrator i shoqërisë

